



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.01.2024

Nr: 04

Ora: 10:30

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 01, DATË 04.01.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI PARTIA "POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.01.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia "Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë"

OBJEKT: 1. Kundërshtimin e vendimet nr. 823, datë 07.12.2023 të KSHZ "Për Miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021", konkretisht pikës 96 të tij, për "Marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, sipas 23/4, pika 2 të ligjit "Për partitë politike".



2. Shfuqizimin e pikës 96, të vendimit nr. 823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021"

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja "b", 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti Partia "Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 01 regj., datë 04.01.2024.

Në mbledhjen e datës 12.01.2024, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 01, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja "a", të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja "a" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 01, datë 04.01.2024, të paraqitur nga subjekti Partia "Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë".
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 12.02.2024, ora 12:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	Lako	-	Anëtar
Elvis	Çefa	-	Anëtar
Ilijan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar